



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

RELACION

PËR

**“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 1 TË MARRËVESHJES NR. 10216/1 PROT.
DT. 25.11.2022 NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A. PËR ZGJEDHJEN E
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT
TATIMOR”**

Midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A, është nënshkruar marrëveshja Nr. 10216/1 Prot dt. 25.11.2022 “Për zgjedhjen e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A. si agjent tatimor, për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore familjare të Bashkisë Korçë.

Në marrëveshje janë përcaktuar në mënyrë të ndërsjelltë të drejtat dhe detyrimet e palëve që do të lindin nga zbatimi i objektit të marrëveshjes.

Në nenin që përcakton të drejtat dhe detyrimet e paleve, pika 1 të marrëveshjes është përcaktuar se Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a. në rolin e agjentit tatimor, është ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Korçë si më poshtë vijon:

- Taksa mbi ndërtesën për familjarët;
- Tarifa për pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin, mirëmbajtja e varrezave, për familjarët rezidentë efektivë;
- Taksat dhe tarifave vendore për familjarët të Njërive Administrative të Bashkisë Korçë.

Me shkresë nr. 1121 prot dt. 09.02.2024 nga DTTV në Bashkinë Korçë, kërkohet që agjenti tatimor SHRUKKO përveç sa më sipër, ti shtohen për t’u mbledhur dhe taksa mbi tokën bujqësore, tarifa vjetore e shërbimit, mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues. Mbledhja nga agjenti tatimor SHRUKKO i taksave dhe tarifave të sipërcituara, bëhet me qëllim

identifikimin sa më të saktë të taksapaguesve efektivë, përditësim të dhënash, ofrimin e mundësisë të pagesës me këste si dhe maksimizimin e arkëtimit të këtyre detyrimeve.

Sa më sipër, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, nenin 9/1.3 pika b, 1.4, 1.6, 35, 54/ë/f. 64/c të Ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 5, 32/2 të Ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjt Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i kërkohet Këshillit të Bashkisë Korçë, të miratojë, ndryshimin e nenit “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pikA 1, të marrëveshjes Nr. 10216/1 prot. dt. 25.11.2022 nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë, me përmbajtje si më poshtë:

“Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë është agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Korçë si më poshtë:

- Taksa mbi ndërtesën për familjarët;
- Tarifa për pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin, mirëmbajtja e varrezave, për familjarët rezidentë efektivë;
- Taksat dhe tarifat vendore për familjarët të Njërive Administrative të Bashkisë Korçë;
- Taksa mbi tokën bujqësore;
- Tarifa vjetore e shërbimit, mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues.”

Drejtoe e Përgjithshme: A. Qeramixhi (Dishnica)

Drejtor i DTTV: Soniel Prifti

KRYETAR I BASHKISË

Sotirag Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2024

PËR

“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 1 TË MARRËVESHJES NR. 10216/1 PROT. DT. 25.11.2022 NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A. PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT TATIMOR”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, nenin 9/1.3 pika b, 1.4, 1.6, 35 54/ë/f, 64/c të Ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 5, 32/2 të Ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjt Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e nenit “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 1, të marrëveshjes Nr. 10216/1 prot. dt. 25.11.2022 nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujës-jellës Kanalizime Korçë e cila do këtë përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Shoqëria Rajonale Ujës-jellës Kanalizime Korçë, është agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Korçë si më poshtë vijon:

- *Taksa mbi ndërtesën për familjarët;*
- *Tarifa për pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin, mirëmbajtja e varrezave, për familjarët rezidentë efektivë;*
- *Taksat dhe tarifat vendore për familjarët të Njësive Administrative të Bashkisë Korçë;*
- *Taksa mbi tokën bujqësore;*
- *Tarifa vjetore e shërbimit, mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues.”*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

BASHKIA KORÇE
NR 1121 PROT
DATA 09/02/2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Lënda: Kërkesë

Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe të Burimeve Njerëzore

Jua
Prifti

Në vijim të komunikimit me SH.R.U.K.KO sh.a si dhe marrëveshjes të lidhur midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetës Kanalizime Korçë Sh.a të datës 25.11.2022 e cila konsistonte në mbledhjen nga agjenti tatimor SH.R.U.K.KO sh.a të taksave dhe tarifave vendore familjare kërkojmë që në këtë marrëveshje në pikën 1 të paragrafit **Të drejtat dhe detyrimet e palëve** të shtohen për tu mbledhur nga agjenti tatimor SH.R.U.K.KO dhe taksa mbi tokën bujqësore dhe tarifa vjetore e shërbimit, mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues. Këtë kërkesë jua drejtojmë me efekt identifikimin më të saktë të taksapaguesve efektive, përditësim të dhënash, ofrimin e mundësisë së pagesës me këste për këto taksa dhe tarifa si dhe maksimizimin e arkëtimit të këtyre detyrimeve.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Drejtori
Soniel Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
Nr. 10210/1 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A
Nr. 321/ Prot.
3

MARRËVESHJE

Sot në datën 25/11 /2022, në Zyrat e Bashkisë Korçë lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet :

Njërës palë: Bashkisë Korçë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. Sotiraq Filo dhe

Palës tjetër: Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A, nipt: M24431001N, përfaqësuar nga Administratori, Z. Petrit Tare,

në mbështetje të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, e akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative ", me përmbajtjen si më poshtë vijon :

Objekti i Marrëveshjes

Marrëveshja konsiston në mbledhjen nga agjenti tatimor i ngarkuar Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A, të taksave dhe tarifave vendore familjare të Bashkisë Korçë.

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet palëve pjesëmarrëse në të, marrëdhënie këto që do të lindin nga zbatimi i objektit të marrëveshjes.

Të drejtat dhe Detyrimet e palëve

1. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A është agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Korçë , si më poshtë:

... taksës mbi ndërtesën për familjarët;

- tarifave për pastrim, gjelbërim dhe ndriçim, mirembajtje varreza, për familjarët rezidentë efektivë ;
- taksave dhe tarifave vendore për familjarët të Njësive administrative të Bashkisë Korçë.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A në cilësinë e agentit të mbledhjes të taksave dhe tarifave vendore është e detyruar:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet.

b) të paguajnë për llogari të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, taksat dhe tarifatat vendore të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

3. Shuma vjetore e taksave dhe tarifave vendore e llogaritur për t'u paguar nga taksapaguesit, paguhet me këste mujore dhe gjenerohet në faturën e ujit të pijëshëm dhe është e ndarë veçmas në një rresht më poshtë nga totali i faturës me tvsh të konsumit të ujit për t'u paguar nga konsumatori.

4. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, i përcjell Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A, brenda datës 15 janar të çdo viti, listën emërore të kategorive të përjashtuara nga pagimi i taksave dhe tarifave vendore, si dhe gjatë vitit përditësimet përkatëse, nëse ka.

5. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A në rolin e agentit të taksave dhe tarifave vendore, për shërbimin që kryen dhe me qëllim mbulimin e kostove të lidhura me këtë rol, përfiton 2 (dy) % komision të llogaritur mbi masën e taksave dhe tarifave vendore që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë 98% të shumës së arkëtuar.

Të dyja palët hartojnë dhe firmosin Akt Rakordimin e tarifave dhe taksave të mbledhura për muajin sipas Modelit të Akt Rakordimit bashkëngjitur kësaj Marrëveshje.

Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A vetëllogarit shumën që përfiton nga komisioni duke shumëzuar përqindjen e komisionit, me vlerën e arkëtimit nga taksat dhe tarifatat vendore për periudhën tatimore dhe mban drejtpërsëdrejti vlerën e komisionit që përfiton si dhe deklaron dhe paguan në llogari të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që përfiton.

6. Të ardhurat e përfituara në formën e komisionit nga Agjenti Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A, do të përdoren për nevojat e vetë shoqërisë.

marrëdhëniet ndërmjet palëve që nuk janë përmendur në këtë marrëveshje do të zbatohen
dispozitar ligjore të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje pasi u përpilua në dy kopje u pranua dhe u firmos nga palët.

PALET KONTRAKTUESE



Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A

Administratori

Petrit Tare

